



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
NJËSIA E PROKURIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNE

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksion i Rruges se Lapardhase”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Asfalt, çakëll dhe rërë bitumi

VLERA E FONDIT LIMIT: 58,333,202.43 lekë (pesedhjet e tete milion e treqind e tridhjet e tre mije e dyqind e dy pike dyzet e tre) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Bashkia Selenice** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi : Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 34 dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua në nenin 76 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pika

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve bazuar në pikën 2, neni 19 i VKM – së Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, hartues të projekt – preventivit rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës.

Afati i realizimit të punimeve është 6 (gjashtë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8,
- b. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;

Argumentimi: Kriteri (a) eshte vendosur ne baze te nenit 82 të LPP dhe nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri (b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

1.1 Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të biznesit”, të ndryshuar.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, ku vlera e xhiros per 3 (tre) vitet e fundit duhet te jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.1.2 Operatorët ekonomike duhet te paraqesin bilancet vjetore, per vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, te shoqeruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetem ne rastin kur jane ne kushtet e percaktimeve te *ligjit Nr.10 091, date 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve te njepasnjeshme, nuk duhet te kene raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. i cili parashikon se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën

dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor, sipas ekstraktit të regjistrimit, për vitin 2025 e keket e maturuara për vitin 2026. Vërtetimi duhet detyrimisht të jetë përshkruar, ndër të tjera, edhe NIPT-in e subjektit. Ne të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument në momentin e dorëzimit të dokumentave).

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2025 e keket e maturuara për vitin 2026, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrorjnë aktivitet, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore, në Ligjin Nr. 9 920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 "Për QKB" i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 "Për QKR", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

- **Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:**

a) Kontraten e Siper marrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Fatura Tatimore

d) Aktin e Kolaudimit të objektit

e) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

f) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- **Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:**

a) Kontraten e Siper marrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Fatura tatimore perkatese, të deklaruara në organet tatimore

d) Aktin e Kolaudimit të objektit

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten noteriale të bashkimit të

operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

- Prokurë materiale perfaqesimi, nënshkruar nga të perfaqësuarit e BOE-s.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Pika a) plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika b)** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçense të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën perkatese të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **Kategoria NP-1** – Punime Germimi në tokë – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-4** – Rruge autostrada – **Klasifikimi B**
- **Kategoria NP-5** – Punime nëntokesore, ura e vepra arti – **Klasifikimi A**

Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:

- **Kategoria NS-5** – Impiante të sinjalistikes ndriçuese të trafikut – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-6** – Sinjalistike rrugore jo ndriçuese – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-7** – Barriera dhe mbrojtje rrugore – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** – Punime topogjeodezike – **Klasifikimi A**

** Per Operatoren e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane , pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).*

Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.

* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t`i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

** Per Operatoren e huaj te behet njehesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e liçensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t`i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet Licensa Profesionale.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmim dheu	A	0 - 21 milion
NP-4	Rruge autostrada	Punime për shtresat asfaltike	B	21-50 milion
NP-5	Punime nëntokesore, ura e vepra arti	Punime për ura e vepra arti të vogla	A	0 - 21 milion
NS-4	Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to	Ndërtim mure me blloqe betoni	A	0 - 21 milion
NS-5	Implante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut	Sinjalistike ndriçuese të trafikut	A	0 - 21 milion
NS-6	Sinjalistike rrugore jo ndriçuese	Punimet për vendosjen e sinjalistikës	A	0 - 21 milion
NS-7	Barriera dhe mbrojtje rrugore	Punimet për vendosjen e barrierave mbrojtëse	A	0 - 21 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Piketimin e punimeve	A	0 - 21 milion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)
- ISO 45001:2018/45001-2023 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë)

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, të ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Për ISO 45001:2018: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollat e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë liçencë të vlefshme:

- Kodi III.2.B - Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme inerte dhe dhera si mbetje të parrezikshme (mbetjet që dalin nga punimet) Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra

Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **21 (njëzet e një) punonjës** me kohe të plote pune për periudhën e **3 (tre) muajve të fundit** Prill-Maj- Qershor nga data e hapjes së ofertave, ku Stafi Teknik dhe punetoret e kualifikuara të jenë me kohe të plote pune për periudhën e fundit **3 (tre) muajve** (Prill-Maj- Qershor 2026).

Per vertetimin e këtij kushti të paraqiten:

1. Vertetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesipërme.
2. Listepagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, nenit 77, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, Pika 6/ç, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomik të deshmohen që kanë fuqi minimale puntore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin e fuqisë puntore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përllogaritje të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr 216 Datë: 13.04.2023” Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemit të Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim në këtë kontekst autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit orëve të punës (8 orë në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë puntore janë përllogaritur punetoret e kualifikuara. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen **21 (njëzet e një) punonjës** me kohe të plote.

Nr.	Nr. An.	Përshkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Ore pune punetori	Ore totale	Ore pune makineri	Ore totale
						15,232.22		6,624.55
1	2.426/5	Prishje mure betoni	m3	3.9	16.3	63.57		0
2	3.104/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	4286		0	0.053	227.158
3	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir 3	m3	260		0	0.52	135.2
4	3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	4138		0		0
5	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	112		0	0.109	12.208
6	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	2450	0.34	833	0.14	343
7	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	11500	0.21	2415	0.2625	3018.75
8	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	11500	0.075	862.5	0.073	839.5
9	3.711	Shtrese Stabilizanti 8 cm	m2	1300	0.05	65	0.078	101.4
10	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave, 5cm, me makineri	m2	9030	0.109	984.27	0.021	189.63
11	3.224/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	9030	0.082	740.46	0.015	135.45
12	3.401/1	Gjeotekstil me gramature 280 g/m2	m2	500	0.09	45		0
13	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	80	5.6	448		0
14	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	240	5.3	1272		0
15	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	86	0.04	3.44	0.04	3.44
16	3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni	m	36	4.4	158.4		0
17	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	m	44	5.6	246.4	0.25	11
18	3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni	m	13	8.2	106.6	0.25	3.25
19	3.369	Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni	m	8	15.9	127.2	0.43	3.44
20	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	273	12.8	3494.4	2.29	625.17
21	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	194	12.8	2483.2	2.29	444.26
22	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	50	2.9	145		0
23	3.653	F.V. Tuba plastmasi ø 150	m	60	0.5	30		0
24	3.654	F.V. Tuba plastmasi ø 100	m	40	0.31	12.4		0
25	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	1.1	60	66	0.63	0.693
26	3.955	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	2	0.5	1		0
27	3.936	F.V. Tabela trekendore e vogel me A = 60	copë	6	0.5	3		0
28	3.924/2	F.V. Sinjale "emër rruge" LxH normal 80x25	copë	1	0.5	0.5		0
29	3.184	F.V. Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane, W3	ml	50	1.74	87	0.3	15
30	3.942	Vijejim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt)	ml	5160	0.1	516	0.1	516
31	An + 2.519	F.V tub pvc Ø 90 (per kullimin e ujrave ne mure)	ml	16	1.43	22.88		0

Totali ore pune puntori 15,232.22 / (8x22x6) = 14.42

Totali ore pune puntori per makinerit 6,624.55 / (8x22x6) = 6.27

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje 3 (tre) muajt e fundit tregon

besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit i parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarres, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialiste dhe çertifikimet perkatëse, si me poshte:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarres duhet të kenë në liçence të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në piken 2.3.4, stafin inxhinierik si me poshte:

- **Minimumi 1 Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)**
- **Minimumi 1 Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktura)**
- **Minimumi 1 Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit Infrastruktura Transporti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore për shtratat rrugore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, u referohet analizave Nr. 3.210, 3.212/b, 3.711, 3.222/1, 3.224/1, 3.401/1.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve, u referohet analizave Nr. 2.426/5, 3.164/1b, 3.210, 3.331, 3.332, 3.396/1, 3.365, 3.366, 3.367, 3.369, 3.243, 3.244, 2.166.
- **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** janë përgjegjës për saktësinë e vëllimeve të germimit dhe

sasite e punimeve sipas matjeve topogjeodezike te parashikuara ne projekt dhe kryerjen e azhurnimeve topografike, te cilat shtrihen ne te gjithe objektin, u referohet analizave Nr. 3.104/b, 3.124/1a, 3.158/3a, 3.89/a, 3.164/1b, 3.210, 3.244.

b) Stafi mbështetës Operatori ekonomik duhet te ketë te disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si: Deshmi profesionale te punonjesve ose ekuivalent te tij/saj, , punonjesit e mëposhtëm me specialitetin si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë sipas pikës mesipërme (2.3.4) :

- 2 (dy) Teknik i mesëm Ndërtimi (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Hekurkthyes (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Karpentier (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) Betonues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 1 (një) Punëtor Asfalti / Asfaltoshtrues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 1 (një) Punonjës për konstruksionet metalike (Me Certificate Trajnimi / Diplome)

* Ne lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet te disponojë dokumentacionin që verteton profesionin si :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme
- Për stafin e mesipërme, Deshmia e kualifikimit/ certificate dhe/ose diploma e cila të jetë e leshuar nga Ministria e Financave ose të njihet nga Ministria e Punës Ceshtjeve Sociale të paraqitet certificate/diploma profesionale për secilin. Certificatekat / diplomat duhet të jenë të leshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kërkesë po ashtu është në përputhje me vendimin nr. 441/2020, datë 09.10.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik. Diplomat/certificatekat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licensuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbejnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike.
- Certificate të sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione të autorizuar nga /ish (IQT) e cila të jetë e leshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë
- **Diplome** nga institucionet e arsimit të mesëm profesional(publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH*”, kontrate pune të vlefshme dhe të figurojë në listepagesa.
- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës	Nr. Amzës/ekuivalent diplomes/certificate profesionale	Institucioni/ Subjekti certificatekues	Data e vlefshmerisë së certificatekës profesionale
----	--------------	------------	---	--	--	--

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-se, dhe në këtë rregullë”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “**Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2**

te këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik i mesem Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit, *u referohet analizave Nr. 2.426/5, 3.164/1b, 3.210, 3.331, 3.332, 3.396/1, 3.365, 3.366, 3.367, 3.369, 3.243, 3.244, 2.166.*
- **Hekurkthyes** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve referuar zërave të analizave te punimeve te preventivit te objektit, *u referohet analizave Nr. 3.331, 3.332, 2.166.*
- **Karpentier** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë te punimeve, referuar zërave të analizave te preventivit te objektit, *u referohet analizave Nr. 3.396/1, 3.243, 3.244.*
- **Betonues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve te betonit sipas zerave te preventivit te punimeve, *u referohet analizave Nr. 3.243, 3.244*
- **Punetor asfalti** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve asfaltimit sipas zerave te preventivit te punimeve per Objektin ne fjale, *u referohet analizave Nr. 3.212/b, 3.7113.222/1, 3.224/1.*
- **Punonjës për konstruksionet metalike (Me Certificate Trajnimi / Diplome)** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve asfaltimit sipas zerave te preventivit te punimeve per Objektin ne fjale, *u referohet analizave Nr. 3.184, 3.955, 3.936, 3.924/2.*

c) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certificate/dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, punonjës me specialitetin si më poshtë:

- ☐ Minimumi **1 (një) persona** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certificatekat e cituara më sipër dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon

ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" si dhe Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, nëpërmjet djes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 (tridhjetë milion) në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kriteri i vendosur për disponimin e numrit prej mesatarisht të paktën 45 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në këtë përlllogaritje njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, dhe në perfundim, në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre

kushteve.

- Në staf përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtues të mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve, grafikun, llojin dhe natyrën e punimeve që do të kryhen si: gërmime, ngjeshje, sistemime, shtrim tombino, punime për pusetat, rehabilitimi i segmenteve rrugore etj, të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit të veprës.

- Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- **Konkretisht:** Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoroz të punimeve.

- **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e Drejtuesve teknik (Inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojë se ka të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Automakinist 1 (nje)
- Buldozerist 2 (dy)
- Eskavatorist 2(dy)
- Shofer 2 (dy)

(Në rastet kur mjetet/makinerite dispononohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Per këte operatore të ekonomike duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “*Per kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhenien e Dëshmise së Aftësive Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*”, miratuar me urdherin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatore të ekonomike të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

2.3.9 Makineri, Pajisje

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuar këto me

dokumentacionin perkates;

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamion me vinç	2 copë	Në pronësi ose me qera
Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 10-18 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
Rrul hekur-hekur	1 copë	Në pronësi ose me qera
Rrul gome -hekur	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autobitumatrice (pajisur me çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Pajisje Per sperkatje Bitumi (Mjet teknologjik me goma minimumi 9000 Litra pajisur me çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm)	1 copë	Në pronësi ose me qera
Rrul Gom - Gom 9-15 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Sistem 3D Menaxhim dhe Kontroll(systemcMachine Controll) per nivelim asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkiator mbi 50 ton per transport makinerish	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
Fadrom me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhirra deri 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Ekskavator me zinxhirra mbi 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Miniskavator	2 copë	Në pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autopompe betoni	3 copë	Në pronësi ose me qera
Pompe(prese) betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
Betoniere(Motobetoniere) kantieri	3 copë	Në pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
Gjenerator 220 kva	1 copë	Në pronësi ose me qera
Makineri vijejimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
Gps lazer + rover	1 copë	Në pronësi ose me qera
Pompe uji	3 copë	Në pronësi ose me qera
Makineri (tranxh) per prerje hekuri	1 copë	Në pronësi ose me qera
Makineri (elektrobango) per kthim hekuri	1 copë	Në pronësi ose me qera
Fabrike Betoni jo me larg se 30 km nga fshati Kote (me planvendosje / genplan) pajisur me QKL / mobile e levizeshme	1 copë	Pronesi, me qera ose aktmarreveshje furnizimi
Fabrike Asfalti jo me larg se 30 km nga fshati Kote (me planvendosje / genplan) pajisur me QKL / mobile e levizeshme	1 copë	Pronesi, me qera ose aktmarreveshje furnizimi
Karroca dore	5 copë	Në pronësi ose me qera
Depozite uji 1000 liter	3 copë	Në pronësi ose me qera
Batipal me cekic pneumatik	2 copë	Në pronësi ose me qera
Vinc kulle ton 6-10	1 copë	Në pronësi ose me qera

- b) Gjithashtu ne zbatim te VKM-se Nr.312, date 05.05.2010, operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje mjete dhe pajisje mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit, si me poshte:
- Kokore – *jo me pak se 20 cope*
 - Jeleke – *jo me pak se 20 cope*
 - Prozhektore ndriçimi naten – *jo me pak se 15 cope*
 - Komplet i ndihmes se shpejte – *jo me pak se 5 cope*
 - Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo me pak se 10 cope*

Argumentimi:

Ligjor: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

Teknik: Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim .”

Konkretisht:

- Kamion me vinç *u referohet analizave Nr. 3.365, 3.366, 3.367, 3.369*
- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-18 ton *u referohet analizave Nr. 2.426/5, 3.158/3a, 3.164/1b, 3.222/1, 3.224/1, 3.396/1, 2.258, 2.166, An+2.2519*
- Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton *u referohet analizave Nr. 2.426/5, 3.158/3a, 3.164/1b, 3.222/1, 3.224/1, 3.396/1, 2.258, 2.166, An+2.2519*
- Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton *u referohet analizave Nr. 2.426/5, 3.158/3a, 3.164/1b, 3.222/1, 3.224/1, 3.396/1, 2.258, 2.166, An+2.2519*
- Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton *i referohet analizës Nr. 2.426/5, 3.158/3a, 3.164/1b, 3.222/1, 3.224/1, 3.396/1, 2.258, 2.166, An+2.2519*
- Rrul hekur-hekur *i referohet analizës Nr. 3.210, 3.164/1b, 3.212/b, 3.711, 3.222/1, 3.224/1*
- Rrul gome -hekur *i referohet analizës Nr. 3.210, 3.164/1b, 3.212/b, 3.711, 3.222/1, 3.224/1*
- Autobitumatrice (pajisur me certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm) *i referohet analizës Nr. 3.222/1, 3.224/1*
- Pajisje Per sperkatje Bitumi (Mjet teknologjik me goma minimumi 9000 Litra pajisur me certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm) *i referohet analizës Nr. 3.222/1, 3.224/1*
- Rrul Gom - Gom 9-15 Ton *i referohet analizës Nr. 3.210, 3.164/1b, 3.212/b, 3.711, 3.222/1, 3.224/1*
- Sistem 3D Menaxhim dhe Kontroll(systemcMachine Controll) per nivelim asfalti *duhet me qellim kryerjen e sakte te hedhjes se sasise se asfaltit ne rruge dhe pjerresin teknike te shtreses, i referohet analizës me Nr. 3.222/1, 3.224/1*
- Rimorkiator mbi 50 ton per transport makinerish nevojitet per transportin e rulave, eskavatoreve dhe asfaltoshtrueses *i referohet analizës Nr. 3.210, 3.164/1b, 3.212/b, 3.711, 3.222/1, 3.224/, 3.222/1, 3.224/1, 3.396/.*
- Asfaltoshtruese *i referohet analizës Nr. 3.222/1, 3.224/1,*
- Eskavator me goma *i referohet analizës me nr. 3.104/b, 3.124/1a, 3.89/a, 3.164/1b.*
- Fadrom me goma *i referohet analizës me nr. 3.396/.*
- Eskavator me zinxhirra deri 20 ton *i referohet analizës me nr. 3.104/b, 3.124/1a, 3.89/a, 3.164/1b.*
- Ekskavator me zinxhirra mbi 20 ton *i referohet analizës me nr. 3.104/b, 3.124/1a, 3.89/a, 3.164/1b.*
- Miniskavator *i referohet analizës me nr. An, 3.104/b, 3.124/1a, 3.89/a, 3.164/1b*
- Grejder *i referohet analizës me nr. 3.210, 3.212/b, 3.711.*
- Autopompe betoni *i referohet analizës me nr. 3.222/1, 3.224/1*

- Pompe(prese) betoni i referohet analizës me nr. 3.243, 3.244.
- Betoniere(Motobetoniere) kantieri i referohet analizës me nr. 3.243, 3.244.
- Vibrator betoni i referohet analizës me nr. 3.243, 3.244.
- Gjenerator 220 kva u referohet analizave Nr. 3.212/b, 3.164/1b, 3.244/1, 3.243, 3.244
- Makineri vijezimi i referohet analizës me Nr. 3.942.
- Gps lazer + rover per piketimet e te gjithë segmentit te rruges i referohet analizës me Nr. 3.104/b, 3.124/1a, 3.89/a, 3.164/1b, 3.210, 3.212/b, 3.711, 3.222/1, 3.224/1, 3.243, 3.244
- Pompe uji i referohet analizës me Nr. 3.212/b, 3.711.
- Makineri (tranhx) per prerje hekuri i referohet analizës Nr. 3.331, 3.332, 2.166,
- Makineri (elektrobango) per kthim hekuri i referohet analizës Nr. 3.331, 3.332, 2.166
- Batipal me cekic pneumatik i referohet analizës Nr. 3.184,
- Vinc kulle ton 6-10 i referohet analizës Nr. 2.166
- Fabrike Betoni pajisur me QKL / mobile e levizeshme, jo më larg se 30 km nga vendi i punimeve u referohet analizave Nr. 3.222/1, 3.224/1

Argumetim teknik per distancën e transportit te betonit Distanca prej 30 km nga objekti argumentohet bazuar ne qendrueshmerine(viskozitetit) e materialit te betonit i cili duhet te ruaj parametrat teknik perpara hedhjes ne veper. Nese distanca e transportit te betonit do te jete me e madhe se 60 min deri ne veper, kjo do te krijonte demtim te materialit.

Me planvendosje/genplan per te treguar me saktësisht qe largësia e kerkuar eshte e sakte.

- Fabrike Asfalti pajisur me QKL jo më larg se 30 km nga vendi i punimeve i referohet analizës Nr. 3.222/1, 3.224/1

Argumetim teknik per distancën e transportit te asfaltit referuar specifikimeve teknike distanca prej 30 km nga objekti argumentohet bazuar ne qendrueshmerine e materialit te asfaltit i cili duhet te ruaj parametrat teknik perpara hedhjes ne veper. Me planvendosje/genplan per te treguar me saktësisht qe largësia e kerkuar eshte e sakte.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomik mjetet dhe paisjet teknike Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës ne lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

❑ Per vertetimin e disponimit te makinerive dhe pajisjeve te kerkuara me lart, te paraqiten:

- 1- Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikaten e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).
- 2- Per mjetet e siguruar me qira, te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi, shoqeruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar plus dokumentat qe verteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikaten e Kontrollit Teknik (*te vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*te vlefshme*).
- 3- Per paisjet ne pronesi te shoqerohen me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).
- 4- Per paisjet me qera te paraqitet kontrata e lidhur para noterit per kete objekt, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt e ketij prokurimi, shoqeruar me Akt - Pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi*).
- 5- Operatori ekonomik nuk duhet t'i kete kapacitetet teknike te angazhuara ne kontratat te tjera dhe nuk duhet te jene te deklarurara ne procedura te shpallura fituese (**deklarate me shkrim nga Administratori**

i Shoqerise)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.11 Kontroll ne kantier nga ana e autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor kur e shikon te arsyeshme perpara shpalljes te njoftim fituesit paraprak ben vizite ne kantier per te verifikuar kapacitetet teknike nese keto kapacitete jane te disponueshme vetem per realizimin e kesaj kontrate. Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ose nëse AK e shikon nevoja për tu kërkuar sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjerë të veçantë, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Person përgjegjës

Specialist i Fushes

Fondi Limit